

Përkthim jozyrtar

Bruksel, 02.03.2020

SWD(2020)47 versioni final

DOKUMENT PUNE I SHËRBIMEVE TË KOMISIONIT

Dokument i përditësuar për Republikën e Maqedonisë së Veriut

Dokument i përditësuar për Republikën e Maqedonisë së Veriut¹

1. Hyrje

Në prill të vitit 2018, Komisioni rekomandoi të hapen negociatat për aderim me Republikën e Maqedonisë së Veriut². Në konkluzat e veta të qershorit të viti 2018, Këshilli konfirmoi progresin e arritur dhe hapi rrugën drejt fillimi të negociatave për aderim në qershor të vitit 2019³. Këshilli theksoi se përqindja e progresit duhet të jetë pjesë e Raportit vjetor të Komisionit dhe të përfshij materiale shpesh dhe rezultate të qëndrueshme, në veçanti për:

- Reforma në gjyqësor dhe hetime proaktive, ndjekje penale dhe aktgjykime përfundimtare për rastet e korrupsionit dhe krimin të organizuar, duke përfshirë këtu edhe nivelin e lartë
- Reforma në shërbimet inteligjencës dhe të sigurisë
- Reforma në administratë publike

Në përputhje me konkluzat e Këshillit, Komisioni filloi punën përgatitore, duke përfshirë sqarimin teknik të kapitujve të së *drejtës së BE-së (acquis)*. “Duke e pasur parasysh progresin e rëndësishëm të arritur dhe kushtet e përmbushura unanimisht të konfirmuara nga Këshilli në qershor të viti 2018”. Komisioni në maj të vitit 2019, propozoi të fillohen negociatat për aderim me vendin⁴. Në qershor të vitit 2019, Këshilli e prolongoi vendimin për më së voni në tetor të vitit 2019⁵. Këshilli Evropian në tetor solli vendimin “sërish të shqyrtohet çështja e zgjerimit para samitit të BE - Ballkani Perëndimor në Zagreb, në maj të vitit 2020”⁶

Pas rezultatit të Këshillit të Evropian në tetor të vitit 2019, Liderët politik bashkërisht u ranë dakord të organizojnë zgjedhje të parakohshme Parlamentare me 12 prill të vitit 2020. Në përputhje me legjislaturën Nacionale, me 3 janar të vitit 2020 u emërua Qeveria teknike, e kryesuar nga Kryeministri Spasovski, duke i përfshirë dy Ministra dhe tre Zëvendësministra nga partia më e madhe opozitare. Krahas organizimit të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, prioritetet strategjike përfshinë edhe hapjen e negociatave aderuese me BE-në, përfundimi i aderimit në NATO, reforma në gjyqësor, luftë kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar dhe zbatim të Marrëveshjes kornizë të Ohrit. Kuvendi u shpërnda me 16 shkurt 2020.

2. Plotësim për reformat e zbatuara

Maqedonia e Veriut dha rezultate konkrete në implementimin e saj të vazhdueshëm, të reformave që kanë të bëjnë me BE-në dhe me marrëdhëniet mira fqinjësore. Lidhur me reformat, vendi u fokusua posaçërisht në fushat e përcaktuara në Konkluzat e Këshillit, siç vijon:

- **Reforma gjyqësore dhe hetime proaktive, ndjekjet penale dhe aktgjykime përfundimtare për raste të korrupsionit dhe krimin të organizuar, duke përfshirë këtu edhe nivelin e lartë**⁷

Reforma në gjyqësor

¹ Ky dokument i përditësuar përfshin periudhën e Konkluzioneve të Këshillit nga qershori i vitit 2018 deri më sot, duke u plotësuar gjetjet kyçe të pakos për zgjerim të vitit 2019.

² SWD(2018) 450 versioni final

³ <https://www.consilium.europa.eu/media/35863/st10555-en18.pdf>

⁴ SWD(2019)260 versioni final

⁵ <https://www.consilium.europa.eu/en/press/press-releases/2019/06/18/council-conclusions-on-enlargement-and-stabilisation-and-association-process/>

⁶ <https://www.consilium.europa.eu/media/41123/17-18-euco-final-conclusions-en.pdf>

⁷ Informacionet për ndjekje, aktakuza, raste dhe aktgjykime janë nga informacionet me burime të hapura dhe tregojnë se procedurat a janë duke vazhduar apo kanë përfunduar. Numrat bazohen në kontributin e dhënë nga autoritetet nacionale.

Lidhur me reformat në gjyqësor, janë marrë hapa të rëndësishme legislative për përfundimin e pavarësisë së gjyqësorit. Trupat relevant vazhduan të funksionojnë, njëkohësisht duke iniciuar reforma të rëndësishme për përfundimin e efikasitetit të tyre. Siç është theksuar në Komisionin e Venedikut, autoritetet kanë qenë konsistente në përpjekjet e tyre për ti harmonizuar rregullat për sistemin gjyqësor në pajtueshmëri me standardet ndërkombëtare dhe praktikën e mira⁸. Në këtë drejtim, Maqedonia e Veriut, e përforcoi implementimin e reformave të parapara në Strategjinë e tyre për reforma në sektorin e gjyqësorit dhe planit aksionar, duke iu referuar “Reformave Urgjente Prioritare” të mëparshme, rekomandimeve të Komisionit të Venedikut dhe të Grupit të Ekspertëve të lartë për çështje sistemore dhe sundim të ligjit. Monitorimi i reformave është prioritet i nivelit më të lartë dhe ekziston dialog i hapur me Komisionin Evropian dhe partnerët e tjerë për të siguruar cilësi në strategjitë e sjella dhe legjislaturave.

Ekzistojnë një sërë ndryshimesh ligjore apo ligje të reja të sjella në korrik të vitit 2018 (duke e përfshirë edhe Kodin Penal, Ligjin për Gjyqë, Ligjin për Këshillin Gjyqësor, Ligjin për Këshillin e Prokurorëve Publik, Ligjin për Kundërvajtje, Ligjin për Konteste Administrative, Ligjin për Noter, Ligjin për Përmbarim, dhe Ligjin për Ndhimë Juridike Falas). Në vijim është implementimi i kornizës së re ligjore. Këto përpjekje reformuese e risin transparencën në emërim, sjellin kritere cilësore për vlerësimin e gjykatësve dhe rrit përgjegjësinë e gjykatësve dhe anëtarëve të Këshillit Gjyqësor. Këshilli gjyqësor luan rol më aktiv edhe në mbrojtjen e pavarësisë së gjykatësve, edhe në aplikimin e rregullave të përmirësuar disiplinore. Nga korriku i vitit 2019, ai shkarkoi gjashtë gjykatës, mes të cilëve Kryetarin dhe dy gjykatës të Gjyqit Supreme, si dhe tre gjykatës të tjerë (përfshirë këtu edhe kryetarin e mëparshëm të Gjykatës Themelore Penale në Shkup). Mori imunitetin e një gjykatësi të Gjykatës Administrative në maj të vitit 2019 dhe një anëtar të tij i dyshuar në një hetim për mashtrim në dhjetor të vitit 2019.

Pas përfundimit të mandatit të Prokurorisë Special në shtator të vitit 2019, lëndët iu dorëzuan Prokurorisë Publike për tu siguruar vazhdimësia e tyre. Pas diskutimeve intensive disamujore mes partive politike, Ligji për Prokurori Publike u vendos në votim në Kuvend dhe u miratua me 2/3 e shumicës, (respektivisht 80 deputet) me 16 shkurt të vitit 2020. Qëllimi i ligjit është, *mes tjerash*, të sigurohet zgjidhje e qëndrueshme për rastet e Prokurorisë Speciale Publike (PSP), të verifikohet përgjegjësia për veprat penale që dalin nga dhe rreth përgjimit ilegal.

Ndryshimet në Ligjin për Akademinë e Gjykatësve dhe Prokurorëve, në të cilin janë përfshirë disa rekomandime kyçe të misionit vlerësues për trajnim të gjykatësve dhe me çka konfirmohet Akademia si pikë e vetme për hyje në gjyqësor, janë të përgatitura për tu miratuar nga përbërja e ardhshme parlamentare. Lidhur me menaxhimin e lëndëve gjyqësore, inspektimi i sistemit të automatizuar për menaxhim me lëndët gjyqësore (AKMIS) vazhdojnë dhe dhënë rezultate. Autoritetet ndërmorën procedurë disiplinore të shpejtë ku duhej, dhe u ngrit akuza e parë për keqpërdorim të AKMIS. Ligji për menaxhimin me lëndët gjyqësore u miratua nga Kuvendi në shkurt të vitit 2020. Ligji parasheh masa mbrojtëse për tu siguruar funksionim i lirë i sistemit.

Hetime proaktive, ndjekje dhe aktgjykime përfundimtare për rastet të korrupsionit duke e përfshirë këtu edhe nivelin e lartë

Vendi vazhdon të ndërmerr hetime proaktive, ndjekje dhe aktgjykime përfundimtare për rastet e korrupsionit, duke përfshirë këtu edhe nivelin e lartë. I konfirmon trendet pozitive të paraqitura në vitin 2018. Korniza legislative për parandalimin e korrupsionit është përfunduar. U arrit progres i mirë përmes konsolidimit të mëtejshëm të evidentimit për hetim, ndjekje dhe gjykim të rasteve të korrupsionit në nivel të lartë. Këto përpjekje duet të vazhdojnë në përfundim të njëjtë edhe në mënyrë transparente, pa marrë parasysh pozitën apo përkatësinë politike të të dyshuarve.

⁸ [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD\(2019\)008-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-AD(2019)008-e)

- Në vitin 2019, Prokurori Publik për krim të organizuar dhe korrupsion (në kuadër të Prokurorisë Publike) hapi nëntë **hetime** të reja, në të cilat përfshihen 52 të dyshuar (dhe një person juridik), kundër personave zyrtarë të nivelit të lartë (krahasuar me pesë raste me shtatë të dyshuar në vitin 2018 dhe gjashtë raste ku janë të përfshirë 10 të dyshuar në vitin 2017).
- Në vitin 2019 ka gjithsej 38 të dyshuar, të **akuzuar** kryesisht për abuzim të detyrës zyrtare lidhur me shkelje të procedurave për prokurime, ndërtime pa leje ose shitje të paligjshme të tokës shtetërore. Për shembull, 11 persona, përfshirë, edhe ministër të mëparshëm për transport, notarë, nëpunës administrativ dhe nëpunës publik, ishin akuzuar për pretendim për shitje të paligjshme të tokës shtetërore. Vlerësimi i humbjes së buxhetin e shtetëror është rreth 2.6 milion euro. Në një rast tjetër, i akuzuar është udhëheqës i mëparshëm i një partie politike, së bashku me 10 të akuzuar të tjerë, të punësuar kryesisht në komunë, akuzohen për keqpërdorim të pozitës që sjell deri tek ndërtimi pa leje, e vlerësuar me dëm financiar prej 600,000 euro. Në gjykimin vijues, disa nga 11 të akuzuarit fillestar u deklaruan fajtorë në janar të vitit 2020, në këmbim të dënimeve më të lehta.
- Në verën e vitit 2019 u hapën çështje serioze me të ashtuquajturin “rasti zhvatja” në të cilin tre të dyshuar, mes të cilëve edhe Prokurori i mëparshëm Special, **akuzohen** për pretendim për zhvatje të parave dhe shpërdorim të detyrës zyrtare lidhur me rastin e Prokurorisë Speciale Publike. Për njërit prej të akuzuarit iu shqiptua dënim me tre vite burgim, pas pranimit të fajit, me çka vazhdon gjykimi edhe për dy të akuzuarit tjerë.
- Lidhur me rastin, Zëvendëskryetari i Kuvendit është akuzuar për mashtrim dhe larje parash.
- Vazhduan **seancat gjyqësore** për disa raste tjera të theksuara, në të cilat janë të përfshirë funksionar të lartë të mëparshëm.

Prokuroria Speciale Publike, gjithashtu, ishte proaktiv në përcaktimin e përgjegjësisë për ankesat e dëgjuara.

- Gjatë kohës së mandatit të saj, Zyra e Prokurorisë Speciale Publike ngriti kallëzime penale për vepra penale për 21 rastet më të mëdha. Krahas kësaj, ajo i ndërmori edhe rastet paraprake të ndjeshme nga Prokuroria Publike. Gjithsej 26 raste me 164 persona në vjeshtën e vitit 2019 iu dorëzuan Prokurorisë Publike për krim të organizuar dhe korrupsion. Shumë prej tyre kanë të bëjnë me keqpërdorimin e detyrës apo pozitës zyrtare, falsifikimit apo nënshkrimit të reshëm të dokumenteve, abuzim, larje parash dhe mashtrim.
- Në vitin 2018, gjykatat sollën katër **aktgjykime me vendim të prerë** kundër katër personave, duke përfshirë edhe dy aktgjykime të bazuara në pranim të fajit. Gjykatat sollën dënime përfundimtare kundër Kryeministrit të mëparshëm për pranim të shpërblimit për ndikim të paligjshëm dhe kundër ndihmësit të tij për keqpërdorim të detyrës. Për një tjetër të akuzuar, Ministër i mëparshëm për Punë të Brendshme, u gjykua veçmas.
- Në vitin 2019 kishte **aktvendime përfundimtare** në dy raste për kundër të akuzuarve. Ministri i mëparshëm për Punë të Brendshme u dënua me gjashtë vjet burgim. Në rastin e dytë, gjyqi i shpalli të fajshëm një biznesmen dhe një bashkëpunëtor të tij për falsifikim të dokumentacionit për marrjen e tenderit nga kompania shtetërore, për prodhim të energjisë elektrike (ELEM). Personat juridik të përfshirë në këtë rast, gjithashtu, u shpallën të fajshëm. Aktgjykimi për konfiskimin e pronës u konfirmua me ankesë (për 17 milion euro përfitim paligjshëm / dëm të buxhetit shtetëror).
- **Dënimet me burg** iu shqiptuan edhe drejtorëve të mëparshëm të ELEM-it për falsifikim të dokumentacionit për procedurë për furnizimit publik, si dhe për keqpërdorim të detyrës dhe autorizim gjatë furnizimit të softuerit. Gjyqi urdhëroi edhe kompensim financiar për kompaninë shtetërore në vlerë prej 450.000 euro.

- **Në vijim e sipër janë gjykimet për 12 raste**, me dhjetëra seanca gjyqësore gjatë gjithë vitit. Për arsye procedurale, Gjyqi i Apelit urdhëroi rigjykim në një rast kur gjashtë të akuzuarve u shqiptua dënim me burg nga tre deri në katër vjet dhe gjashtë muaj.

Arrestimi i Prokurores së mëparshme Speciale dhe skadimi i mandatit të prokurorëve të cilët punojnë në Prokurorinë Speciale Publike prolongoi procedurën. Si rezultat i kësaj, disa raste që arritën parashkrim në ndjekjen penale apo proceseve gjyqësore, me doemos duhej të rifillohen.

Në rastin tjetër në nivel të lartë që nuk ndërlihet me akuzat për korrupsion, gjyqi i shkallës së parë dënoi 16 persona me dënim me burg, për periudhë prej shtatë deri në 18 vite për pjesëmarrje të tyre në sulmet e prillit në vitin 2017 në Kuvend, për “Akte terroriste me të cilën abuzohet rendi kushtetues i vendit”. Kjo përfshin Ministrin e mëparshëm për Punë të Brendshme dhe Drejtorin e mëparshëm të policisë. Shumica e të akuzuarve ankimuan aktgjykimin, ndërkaq vetë Prokuroria Publike dorëzoi ankesë për shfajësim për një të akuzuar. Në janar të vitit 2020 u dorëzuan akuza shtesë kundër kryetarit të mëparshëm të Kuvendit, Drejtorit të mëparshëm të Drejtorisë për Siguri dhe Kundërbulim (të mëparshme), së bashku me dy ministra të mëparshëm të cilët aktualisht ndodhen në arrest shtëpiak, për organizim të hyrjes papengesë në Kuvend për turmat dhe për personat e marrë vesh për akte të dhunshme. Është parashikuar që seancat gjyqësore të fillojnë së shpejti.

Komisioni i ri Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK), që ka për detyrë të ndalojë korrupsionin, përfshirë këtu edhe kontrollin e mjeteve dhe konfliktit të interesit, është veçanërisht aktive në parandalimin e korrupsionit. U ndërmorën hapa të mëdhenj që të sigurohet që KSHPK të ketë autorizim dhe resurse financiare për ti përmbushur detyrat e veta. Pas revizionit gjithëpërfshirës të kornizës ligjore për përforsim të autorizimeve të tyre, anëtarët e tyre të rinj u emëruan në mënyrë më transparente në shkurt të vitit 2019. Që atëherë, KSHPK e re në mënyrë proaktive i ndjek pretendimet për nepotizëm, përfshirë këtu edhe kyçjen e funksionarëve të lartë në spektrin politik. Ata iniciuan 66 raste lidhur me pretendimet për nepotizëm. Pas hulumtimeve të KSHPK, 37 raste u mbyllën kur konflikti i interesit ose nuk u vendos, apo u mënjanua. Dy raste u dorëzuan në Prokurori Publike. Në 16 rast, nga institucionet kompetente u kërkua që të vepronin sipas vendimit të KSHPK, ndërkaq në 11 raste procedura e KSHPK është në vijim. Për arsye të disa kërkesave ligjore dhe afateve (p.sh. të merren informacione nga organet tjera), akoma nuk janë të zgjidhura të gjitha rastet. KSHPK, gjithashtu, e finalizon strategjinë e re të saj për vitin 2020-2024.

Hetime proaktive, ndjekje dhe aktgjykime përfundimtare për rastet e krimit të organizuar, përfshirë këtu edhe nivelin e lartë

Në fushën e luftës kundër krimit të organizuar, performimi është përmirësuar. Është rritur numri i hetimeve penale të hapura në vitin 2019, lidhur me grupet e krimit të organizuar, në veçanti kundër grupeve që përfshinë numër të madh të të dyshuarve, respektivisht deri në 21 persona për kontrabandim të migrantëve. U hapën 15 hetime kundër 96 personave dhe vazhduan dy hetime nga viti 2018 kundër 15 të dyshuarve. Këto kryesisht kanë të bëjnë me vepra penale kontrabandim të migrantëve ose vepra të lidhura me drogë.

Në vijim janë 20 gjykime (përfshirë edhe para Gjyqit të Apelit) nga lëndë të hapura në vitin 2018 dhe 2019.

Në vitin 2019, aktgjykime të shkallës së parë u shqiptuan kundër 60 personave (në krahasim me 37 personave në vitin 2018). Aktgjykimet përfundimtare u shqiptuan kundër 56 personave. Shumica prej tyre kanë të bëjnë me kontrabandimin e migrantëve ose prodhim të pa-autorizuar dhe tregti me mjete narkotike substanca psikotrope dhe prekursorë.

Bashkëpunimi për implementimin e Ligjit vazhdon të realizohet. Qendra Nacionale për koordinim të luftës kundër krimit të organizuar vazhdon ta përmirësojë këmbimin e informacioneve mes institucioneve relevante.

- **Reforma e shërbimeve të inteligjencës dhe të sigurisë**

Siç u shpall në vitin 2019 Maqedonia e Veriut arriti progres të mirë në reformat e shërbimeve të saja të inteligjencës dhe të sigurisë, keqpërdorimi i të cilave ndodhi në fillim të krizës në vitin 2015 ajo e finalizoi reformën e sistemit për ndjekje të komunikimeve, në pajtueshmëri me rekomandimin e Grupit të ekspertëve të lartë për çështje nga sfera e sundimit të ligjit. Agjencia e re teknike operative është në funksion dhe u sollën procedura të reja intensive. U përforcua kapaciteti për mbikëqyrje nga ana e Kuvendit.

Vendi gjithashtu, filloi me reformën e shërbimeve të saja të inteligjencës në bashkëpunim me NATO-n dhe partnerë tjerë. Agjencia Nacionale për Siguri (ANS) u formua në shtator të vitit 2019 dhe i përfundoi procedurat për punësim. Për dallim të paraardhësit të tij, Drejtoria për siguri dhe kundërzbulim (DSK), ANS dedikohet, për të qenë agjenci e pavarur e vendosur jashtë Ministrisë për Punë të Brendshme dhe pa autorizime policore.

- **Reforma e administratës publike**

Republika e Maqedonisë së Veriut vazhdoi të përparojë në reformat e administratës publike. Transparenca u rrit me miratimin e strategjisë për transparencë 2019-2021 me qëllim të rritjes së transparencës në institucionet publike edhe krahas sjelljes së portalit të hapur qeveritar për të dhëna dhe shpallje më të gjerë të të dhënave për financa publike. Procesi konsultues u përmirësua me një numër të rritur të dokumenteve të marra për propozim rregulloret dhe kyçje më të madhe të shoqërisë civile në proceset e krijimit të politikave.

Filloi analiza funksionale e pushtetit qendror, e dedikuar për sjelljen e propozimit në pranverën e vitit 2020 për përmirësimin e racionalitetit të administratës dhe përkufizimit të përgjegjësive për ta lehtësuar dhënien e shërbimeve publike ndaj qytetarëve dhe aktiviteteve të punës, u përmirësua e-portali Nacional për shërbime, që të shërbejë si pikë e vetme kontakti dhe të krijojë administratë të orientuar më shumë drejt shfrytëzuesve. Regjistri i popullsisë u bë funksional dhe shërben si burim themelor i informatave, si për institucionet shtetërore ashtu edhe për inter-akcionin e qytetarëve me administratën.

Siç u tha edhe më parë⁹, garanca e pavarësisë profesionale dhe përgjegjësisë së administratës si dhe respektimi i parimeve të meritore dhe përfaqësimi i drejtë mbeten thelbësore. Në këtë drejtim, e rëndësisë së veçantë është që Qeveria dhe Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit të vazhdojnë të ndërmarrin aktivitete për çfarëdolloj pretendimi për nepotizëm ose punësim, të cilat nuk bazohen në merita.

3. Konkluzat

“ Duke marrë parasysh progresin e arrirë dhe kushtet e plotësuara unanimisht të konfirmuara nga ana e Këshillit në qershor të vitit 2018, Komisioni në pakon e vetë për zgjerim në vitin 2019 i rekomandoi Këshillit që ti hap negociatat për aderim me Maqedoninë e Veriut. Në përgjithësi, Maqedonia e Veriut i riti përpjekjet e veta dhe solli rezultate të dukshme dhe të qëndrueshme në fushat kyçe të konfirmuara në konkluzat e Këshillit të vitit 2018. Si rezultat i kësaj, bazat për rekomandim të Komisionit për vitin 2019 për fillim të negociatave për aderim me Maqedoninë e Veriut mbeten të vlefshme.

⁹ SWD(2019)218 versioni final

